



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 823/3 Prot.

Tiranë, më 20 /09/2016

VENDIM

Nr. 62, datë 20 / 9 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "Res Publica" përfaqësuar nga Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 823 Prot., datë 27.07.2016, ndaj Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtarë".

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me kërkesën nr. 029/16 Prot., të datës 15.07.2016 ka kërkuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë t'i vihet në dispozicion:

1. Kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer nga Kontrolli Lartë i Shtetit, me objekt "Mbi zbatimin e procedurës ligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve", për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012.
2. Kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që ZVRPP, Korçë ka raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur.

Me shkresën nr. 5536/1 Prot., datë 19.07.2016, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke i sqaruar ndër të tjerat se: "Aksesi i informacionit jepet pasi të vërtetohet interesi legjitim në përputhje me nenin 68, të ligjit nr. 33/2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" si dhe shërbimi i kërkuar ofrohet kundrejt pagesës, sipas tarifave të përcaktuara në ligj "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme".

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri me urdhrin Nr.176, datë 28.07.2016 urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Pubik/ Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Gjatë inspektimit,

përfaqësuesi i Autoritetit Publik sqaroi se: *informacioni i kërkuar mund t'i vihet në dispozicion kërkuar vetëm kundrejt pagesës pasi shërbimet e ofruara nga Zyrat Vendore të Regjistrimit ofrohen me pagesë, por na sqaroi se do të komunikonte me Zyrën Vendore për të urdhëruar vënien në dispozicion të dokumentacionit.*

Pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas konsultimit të legjislacionit, vlerësohet se Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 15, pika 1 e Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” duke refuzuar vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Informacioni mbi kopjet e Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer nga Kontrolli Lartë i Shtetit, me objekt “*Mbi zbatimin e procedurës ligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve*”, për periudhën 01.01.2011-31.12.2012 dhe kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që ZVRPP Korçë ka raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur”, është informacion publik në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014 dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Referenca ligjore e cituar për mosdhënien e informacionit nuk mund të justifikohet në bazë të nenit 71 paragrafi 2 i ligjit nr. 83 datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” pasi dokumentacioni i kërkuar nuk është objekt i ligjit të sipërcituar.

Çdo autoritet publik, në kuptim të nenit 7 pika dh) e Ligjit 119/2014, duhet të ketë publik në programin e transparencës, mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit. Në këto kushte ky lloj informacioni duhet të ishte bërë publik në Programin e Transparencës së autoritetit publik/Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Gjithashtu, Komisioneri me urdhrin nr. 141, datë 20.05.2016 Për miratimin e udhëzuesit “Autoritetet Publike në zbatim të ligjit Për të Drejtën e Informimit”, vlerëson se Autoritet Publik në kuptim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” konsiderohet organi/zyra qëndror(e). Përsa më sipër Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme është Autoriteti Publik përgjegjës për zyrën qendrore dhe të gjitha degët në varësi të saj.

Për sa më lart, duke qenë se informacioni i kërkuar nga Qendra “Res Publica” përbën informacion publik bazuar në nenin 2, pika 2 dhe nenin 7 shkronja “dh” e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe në respektim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, duhet bërë publik në Programin e Transparencës së këtij institucioni.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” ndaj Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr. 823 Prot., datë 27.07.2016, ndaj Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Zyra Qendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (kopjet e Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer nga Kontrolli Lartë i Shtetit, me objekt "Mbi zbatimin e procedurës ligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve", për periudhën 01.01.2011-31.12.2012 dhe kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që ZVRPP Korçë ka raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit), brenda datës 27.09.2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 20.9.2016.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

